



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:027239

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06324407

C.nr.265/23

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Asdren Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. G. nga P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “K. A.”, me adresë U. C..., P., kundër të paditurës Komuna e Podujevës- Drejtoria e Arsimit, me adresë në rr. “N. G.”, P., e përfaqësuar nga përfaqësuesi i komunës për konteste juridike F. R., me objekt kontesti: kompensimi i shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit: 344.25 Euro, jashtë seance, me dt.19.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit A. G.
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A. G., në emër të shpërblimit jubilar, të ia paguaj 75% të pagës bazë dhe atë shumën prej 344.25 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 31.01.2023 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- III. DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A. G. të ia kompensojë shpenzimet e procedurës, dhe atë: për padi shumën prej 104.00 Euro dhe për taksën gjyqësore shumën prej 21.00 Euro, apo shumën e përgjithshme prej 125.00 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi A. G. përmes të autorizuarit të tij, me datën 31.01.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Podujevës- Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpërblimit jubilar, ashtu që ka kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar 75 % të pagës bazë, në shumën prej

344.25 €uro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë gjer në pagesën definitive.

I njëjti në padi ka theksuar se është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura në vendin e punës mësimdhënës, në SHFMU “F. S. N.” në P. Tutje ka theksuar se Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit në Podujevë, edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e nënshkruar me 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në mes palëve në marrëveshje, konform dispozitave të nenit 35, par.8 të marrëveshjes së lartcekur, Ligjit të Punës dhe kontratës individuale, nuk ka bërë kompensimin e pagës jubilarë sipas viteve të përvojës së punës, e cila i ka më shumë se 20 vite dhe i takon 75 % e pagës bazë në shumë prej 344.25 euro (459.00 euro paga bazë), të cilat të dhëna i posedon punëdhënësi për të punësuarën. Tutje shton se pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet konform dispozitave të lartcekura, paditësja detyrohet që për realizimin e kësaj të drejte të i drejtohet gjykatës, ku njëherit i propozon gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave ta aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të dt. 27.09.2024, ka theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit për kompensim të pagës jubilarë, të paraparë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit Para Universitar, të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ngase e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të arsimit. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive, e në rastin konkret, e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive. Tutje ka theksuar se paditësi është dashur që këtë çështje ta inicoj në procedurën administrative dhe më kërkesë t’i drejtohet Drejtorisë së Arsimit tek e paditura dhe nga shkresat e lëndës shihet se paditësi nuk ka bërë kërkesë për kompensimin e pagës jubilarë. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin të shpenzimeve të udhëtimit ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndër gjyqësore nuk ishte kontestuese fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se e paditura i ka më shumë se 11 vite përvojë pune, si dhe fakti se e paditura nuk e ka bërë kompensimin e shpërblimit jubilar.

Andaj, gjykata, konform nenit 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo duke pasur parasysh se nuk ishte kontestuese lartësia e kërkesëpadisë, si dhe duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje: KKAK) të dt.18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, konkretisht nenit 35 par.8, ku është përcaktuar se: *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë*

*shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 marsit të çdo viti”.*

Me dispozitën e nenit 2 të KKAK-së, parashihet se dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucione të arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtar të SBASHK-ut, dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD të universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se në rastin konkret zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje: KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, brenda të cilës periudhë vlerësohet se është arritur viti jubilar nga ana e paditëses.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të fakteve të cilat i kemi cekur më lartë, si dhe dispozitave të lartcekura, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i arsimit të ia kompensojë shpërblimin jubilar, ashtu që, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, duke vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e KKAK-së, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga prova që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe e njëjta nuk ishte kontestuese.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës dhënë në përgjigjen në padi lidhur me atë se komuna nuk është nënshkruese e kontratës kolektive dhe se nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të arsimit, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara, ngase e paditura lidhur me pagesën e shpërblimit jubilar obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga KKAK, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prandaj është edhe irelevante për këtë proces gjyqësor se si e paditura i siguron mjetet për kompensimin e këtyre kategorive.

Lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, duke e llogaritur nga data 31.01.2023, dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve, gjykata e vendosi në bazë të nenit 382 par. 2 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Mendimit Juridik për Kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 par.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se “*Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore*”, ndërsa lartësinë e tyre e mbështeti në Rregulloren e Tarifës së Avokatëve

të Kosovës e vitit 2017, ndërsa për taksë gjyqësore iu referua Udhëzimit Administrativ për Taksa Gjyqësore nr. 01/2017, ku në rastin konkret, e paditura është obliguar që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 125.00 euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, kurse në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 21.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë,  
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil  
C.nr.265/2023, datë 19.10.2023**

**Gjyqtari**  
Asdren Hasani

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.